



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KABINETI

Njoftim për shtyp

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 51% të kapitalit të shoqërisë Trema Engineering 2 Shpk te shoqëria Strabag SE”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e fundit shqyrtoi çështjen me objekt „Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 51% të aksioneve të shoqërisë „Trema Engineering 2“ Shpk te shoqëria “Strabag SE”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të kapitalit 51% të shoqërisë Trema Engineering 2 Shpk te shoqëria Strabag SE”, vërejtë se marrëveshja e nënshkruar nga palët më datë 14 janar 2008 ka për objekt shit-blerjen e 156 451 aksione, të barabarta me 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë Trema Engineering 2 shpk tek Strabag SE. Ky transaksion, që përbën përfitim të kontrollit të një pjesë të kapitalit dhe të së drejtës së votës, është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

Trema Engineering 2 sh.p.k, me seli në Tiranë, është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, zotërohet nga një ortak i vetëm. Shoqëria “**Strabag SE**” është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Austrisë, me seli në Villach, Austri, regjistruar në regjistrin tregtar në Klagenfurt. Strabag SE është pjesë e grupit me të njëjtin emër që ushtron veprimtarinë e vet në tregun e shërbimeve të ndërtimit në Evropën Qendrore dhe Lindore si në: Austri, Gjermani, Republikën Çeke, Sllovaki, Hungari, Poloni dhe Rumani. Strabag SE në vitin 2006 ka qënë e pranishme në tregun kombëtar, nëpërmjet degës së saj në ndërtime civile, konkretisht në ndërtimin e ujësjellsit në Pogradec.

Pas shqyrtimit të raportit, Komisioni i Konkurrencës arriti në konkluzionin se transaksioni i njoftuar i përfitim të kontrollit të paketës prej 51 % të Trema Engineering 2 shpk nga Strabag SE nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të ndërtimit dhe në veçanti të tregut të ndërtimeve civile.

Në këtë kontekst ky përqëndrim nuk shkakton efekte antikonkurrese dhe në kuptim të nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk krijon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim, pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të 51% të kapitalit të shoqërisë Trema Engineering 2 shpk nga shoqëria Strabag SE, me qendër Austri.